



Kërko

LIVE

[Shqiptaria.tv]

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LAJMET E MIRA LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI

PIKË E ZEZË SONDAZHE



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Zjarri në Himarë, Rama takim me banorët: Çfarë s'na vret, na bën më të fortë! Dëshmpërbilim për të prekurit (VIDEO)
- 2

Pas homazheve për Mlladiçin, Vuçiç ashpërsion retorikën ndaj BE-së: Serbët kanë frikë nga Zoti jo nga Marta Kos-ll Shqipëria, Kosova e Kroacia 'na kërcënojnë me aleanca'
- 3

Përplasja te 'Regina Palm', biznesmenët 'kundërshtarë' edhe në dëshmitë! Bedinaj: Më vuri globel! Muça: Jo, konflikt pronësiv! Në kërkim ish-deputeti Bujar Muça (VIDEO)
- 4

Vizita historike e Nënë Terezës në Pukë, flasin njerezit që e takuan 34 vite më parë: Na la amanet të ndërtojmë jo vetëm kishën por dhe xhaminë
- 5

'Kartolinë nga Italia', Adrola Dushi dhe Capital T publikojnë foto nga pushimet

Kronikë VIP & Spektakël

Përplasja e ‘vip’-ave të ekranit/ Eduard Kuçi e shau online, Jozi dhe grupi i tij i zënë ‘pritë’ në Rinas si polica! E detyron të ulet në gjunjë dhe e filmon, vihet në pranga (VIDEO)

Jozefin Marku, i njohur nga pjesëmarrja në një reality show në Shqipëri, u arrestua nga policia, pasi me një grup personazh të tjerë dhunuan dhe poshtëruan një tjetër personazh nga i njëjti format në Kosovë, Eduard Kuçin. Ata i bënë pritë pranë mbikalimit të Rinasit duke e ndaluar makinën e tij luksoze, me disa simbole të kamufluara si të policisë.

Redaksia 5 Shtator, 12:54 | Përditësimi: 5 Shtator, 14:43

Share Post



Dy personazhe të bërë të njohur vetëm nga pjesëmarrja në reality show në Shqipëri dhe **Kosovë**, janë përfshirë në një përplasje të dhunshme, të xituar vetëm nga disa postime në rrjetet sociale.

Fillimisht, **Eduard Kuçi**, një 26-vjeçar nga Kosova, pjesëmarrës në një reality show atje, ofendoi në një video online, Jofezin Markun, 30-vjeçarin që gjithashtu u njoh vetëm se mori pjesë në të njëjtin spektakël, por në **Tiranë**.

“Po i vjen koha dhe atij, ka për të ardhur në Kosovë”, tha ai.

[Sh] .com

LEXO EDHË:

Pas homazheve për Mlladiçin, Vuçiç ashpërsion retorikën ndaj BE-së: Serbët kanë frikë nga Zoti jo nga Marta Kos-ll Shqipëria, Kosova e Kroacia 'na kërcënojnë me aleanca'

Video e Eduard Kuçit ka sjellë më tej një skenë të paprecedentë.

Jozefin Marku nuk ka pritur të shkojë në Kosovë për tu përballur me të, por bashkë me një grup personash të tjerë, i kanë bërë pritë Eduard Kuçit në Shqipëri.

Duke përdorur fenelina si të policisë dhe një tabelë të uniformave blu, grupi i 30-vjeçarit nga Laçi e kanë ndaluar të riun nga Kosova në afërsi të mbikalimit të Rinasit, teksa ky i fundit udhëtonte me një makinë luksoze McLaren.

Menjëherë kanë nisur ta dhunojnë, e si për të fituar krenarinë e humbur, Jozefin Marku, i njohur për publikun si Jozi, i ka kërkuar llogari pse e ka sharë, teksa të tjerët e dhunonin.

Nën frikën e dhunës nga grupi përballë që e godet me shkelma e grushte, e Jozefin Marku që e qëllon me shpulla, Eduard Kuçi, i gjujnjëzuar i kërkon falje.

Jozi: Për çfarë shan, për çfarë përfshihesh kot? Pse më ke sharë?

Edi: Të kam kërkuar falje.

Jozi: Mua me më sha, të q*** r***...

Edi: Jo, jo, të kam kërkuar falje.

Jozi: Ulu në gjunjë, kërko falje. Mos e zgjat më.

Edi ulet në gjunjë: Më fal

Video, e filmuar nga vetë grupi i Jozefin Markut, përfundoi online duke u shpërndarë masivisht, si për të treguar forcën se e mundën një personazh të njohur që i kishte ofenduar online.

Megjithatë, gëzimin ia ndali policia. Shërbimet e komisarariatit numër 6 në Tiranë, e ndaluan 30-vjeçarin Jozefin Marku. Blutë ngritën një sërë akuzash ndaj tij për 5 vepra penale: ‘Heqja e paligjshme e lirisë’, ‘plagosje e lehtë me dashje’, ‘kanosje’, ‘mbajtje pa të drejtë e uniformës’ dhe ‘ndërhyrje e padrejtë në jetën private’

I ndaluar përfundoi edhe shoferi i makinës Land Rover, ku Marku udhëtonte, Kristian Nikolli 31 vjeç. Ai akuzohet për të njëjtat vepra penale si miku i tij, shtuar këtu edhe municion pa leje. Nga kontrolli që policia i bëri në banesë i gjeti 31-vjeçarit sasi municioni, ndërsa makina Land Rover, iu sekuestrua.

“Në lidhje me një video të publikuar në rrjete sociale, në të cilën shfaqet një konflikt ndërmjet disa shtetasve, sqarojmë se: Nga verifikimet e kryera rezultoi se pamjet ishin filmuar në afërsi të mbikalimit të Rinasit. Për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit dhe identifikimin e personave të përfshirë, shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, kanë kryer veprime hetimore në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

Si rezultat i veprimeve të kryera nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, u ndaluan shtetasit J. M., 30 vjeç, për veprat penale “Heqja e paligjshme e lirisë”, “Plagosja e lehtë me dashje”, “Kanosja”, “Mbajtja pa të drejtë e uniformës” dhe “Ndërhyrja e padrejtë në jetën private”, si dhe K. N., 31 vjeç, i cili dyshohet se ka qenë drejtues i automjetit tip “Land Rover”, për veprat penale “Përkrahja e autorit të krimit”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, bombave ose minave dhe i municionit”, “Heqja e paligjshme e lirisë”, “Plagosja e lehtë me dashje”, “Kanosja”, “Mbajtja pa të drejtë e uniformës” dhe “Ndërhyrja në jetën private”. Ndërkohë, u shpallën në kërkim shtetasit A. H., 48 vjeç dhe K. V., 27 vjeç. Gjatë kontrollit të banesës së shtetasit K. N., u gjetën dhe u sekuestruan një sasi municioni, si dhe automjeti tip “Land Rover”, i dyshuar se është përdorur në ngjarje. Këta shtetas dyshohet se, në bashkëpunim edhe me shtetas të tjerë, ende të paidentifikuar, kanë dhunuar shtetasin E. K., 26 vjeç, me pretendimin se ky i fundit kishte fyer një prej tyre”, njofton Policia.

Dy të tjerë nga grup i tyre u shpallën në kërkim, 48 dhe 27 vjeç. Për policinë disa persona të tjerë të përfshirë në dhunimin e Eduard Kuçit, ende nuk janë identifikuar.

Jozi poshtëroi Eduart Kuçin, momenti kur arresti
Report TV



Watch on

Share



Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

SL.E./Shqiptaria.com

TAG: kosove Tiranë Eduard Kuçi Jozefin Marku

Sa e vlerësoni këtë artikull? 3.0 / 5 (4 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

- Tekniku:

05/09/2026 17:36

Sjellja rrugacore bandite e malokerise po l serviret Si normale per qytetarine e Tirones.Gjykata te mos harrojme ti liroje sa me shojt

Përgjigju
- Beni:

05/09/2026 17:24

Kur ska shtet e kuptoni vet se cfare do te ndodhe pas kesaj se nuk i mban as Dubai me po i kthen ne vedet e veta ca porosi te vogla andej nga ku e dine vete shqiptaret dhe do ndodhi mos kini merak po si tha Rama atehere ne ate intervisten e famshe do hane koken e njeri tjetrit gjynah se ja dhe te rini po ky stan kete bylmet ka i prishur stani i mbaruar dhe qelbur bulmeti hajjt tung.

Përgjigju
- Turi:

05/09/2026 14:14

Eh ku kemi perfunduar. Keta "Vipat" kokpalare dalin ekraneve qe jan bere si bordello plot me bundra e keta shulsat.


Përgjigju
- Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Qeveria bllokon pagat e magjistratëve pasi KLGJ e KLP i rritën vetë, si e vlerësoni?

2 Shtator, 23:22

Të drejtë Të gabuar Nuk e di


Lajme të tjera



11 ditë nga vendimi për ish-krerët e UÇK-së, Kosova numëron mbrapsht! Ekrane gjigante në Prishtinë, vizren edhe në Diseldorf (VIDEO)

Benet Beqiri


5 Shtator, 16:21



Vespat ‘pushtojnë Prishtinën’, nis festivali ndërkombëtar! 50 prej tyre nga Shqipëria (VIDEO)


Benet Beqiri

5 Shtator, 16:15




Bashkia e Tiranës jep leje për vendosjen e ashensorëve në pallatet e vjetra, ngre task-forcën për kontrollin e materialeve të sistemit kapot

5 Shtator, 15:59




Kriza politike në Kosovë, PDK paralajmëron aksion politik e juridik! Bedri Hamza: Nuk mjaftohemi më me kërkesa! Në tryezë edhe Gjykata Kushtetuese

5 Shtator, 14:19



Partia Progresive kandidon Vuçiçin për kryeministër: Kemi ndryshuar Serbinë! Sulmon Hagën: Gjykatë e padrejtësisë! Dialog me Kosovën? S'ka kompromise


5 Shtator, 13:08



Porositi gati 5 kg kanabis me THC nga SHBA, i riu frikësohet të tërheqë pakon në postën e Shkodrës! Pas 2 javësh në vëzhgim, kapet në banesë në Bathore (VIDEO)


Sokol Dema

5 Shtator, 11:32



Nga sherri në rrjete sociale te prita në mbikalimin e Rinasit, Joz Marku dhe grupi i tij poshtërojnë Eduard Kuçin përta kamerës! Këngëitari ndalohet në Tiranë


5 Shtator, 11:03



Fundjavi sjell fluks më Morinë, mbi 15 mijë qytetarë të Kosovës hyjnë në Shqipëri në 4 orë (VIDEO)

Benet Beqiri

5 Shtator, 10:53



Padastra: Përfunduum evidentimin e banesave informale në zonën e Selitës së Madhe në Tiranë! Nga 733 ndërtesa, 364 banorë rezultojnë të pajisur me dokumentacion pronësie

4 Shtator, 19:36



Nderimet për Ratko Mlladiç, Kurti sulmon Vuçiçin: Ish-ministri i Millosheviçit po pret me nderime një kriminel lufte! Vështirë të flitet për pëndësë

4 Shtator, 19:16




Në prag të Ditës së Shën Terezës, Bashkia e Tiranës rigjellbëron sheshin në qendër të kryeqytetit

4 Shtator, 18:54




Kosova ngre aktakuzë ndaj 35 ish-zyrtarëve serbë për krimet e luftës në Prekaz, për herë të parë përfshihet masakra ndaj familjes Jashari

4 Shtator, 16:42



Lajmi i fundit



Tre orë bisedime, si shkoj takimi midis të dërguarve të Trump dhe Vladimir Putin?

5 Shtator, 22:47

nga Viviana Mazza

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Pu

Kërko



RAPORTOI Chat live me Shqiptaria.com



×

[sh]

.com

Lajmi i fundit



Tre orë bisedime, si shkoi takimi midis të dërguarve të Trump dhe Vladimir Putin?

5 Shtator, 22:47

nga Viviana Mazza

RAPORTOI Chat live me Shqiptarja.com

